



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

(Auditim Tematik)

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021,
në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
 RAPORT AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA
 NË VITIN 2021 NË ASHK

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	2
		2. Përshkrim i gjetjeve kryesore	
		3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	
II.	Hyrja	1. Objektivi i Auditimit	2-6
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e vlerësimit	
		7. Standardet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit		
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.		
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.		
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".		
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.		
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.		
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.		
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.		
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.		
IV	Gjetje dhe rekomandime		



I. Përmbledhje ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i raportit të auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) ushtroi auditim tematik në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr. 20/10, prot, datë 29.07.202. Kjo shkresë është protokolluar në ASHK me 18/22 prot, datë 02.08.2021. Grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 01.10.2021 Ëmbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2021Ë. Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-konstatim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

I.2. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 19 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative; si dhe janë rekomanduar masa disiplinore òvërejtje deri në largim nga puna ò në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 19 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti janë pranuar 11, ndërsa zbatim i tyre rezultoi: janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 8 rekomandime.
- b. Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore òvërejtje deri në largim nga puna ò në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm, nga ku rezultoi se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, nuk është marrë asnjë masë, për rrjedhojë konsiderohen të pa zbatuara.

II - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 162/4, datë 14.02.2022 nga data 28.02.2022 deri në datën 18.03.2022, në Drejtorinë Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DPASHK), KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë òmbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021Ë.

Auditimi përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.M Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
- 3.O.L, auditues
- 4.R.A auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet DPASHK Tiranë dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Titulli - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 1155/1, datë 11.01.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Marrësi - Drejtoria Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, **Tiranë**.



3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

Qëllimi: Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e auditimit.

4. Identifikimi i çështjes

Drejtoria Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të Kryeministrisë dhe ka për objekt të veprimtarisë:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës është themeluar në maj të vitit 2019 përmes ligjit nr.111/2018 òPër Kadastrën. Me ngritjen e këtij institucioni kanë pushuar së ekzistuari Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimeve (ALUIZNI), kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilave tanimë ushtrohen prej ASHK-së.

- Analizimi i riskut të veprimtarisë së ASHK-së (Drejtorisë së Përgjithshme), me qëllim përcaktimin e pikave të auditimit është bërë në kuadër të ligjit 20/2020 òPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, i cili ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2020.

- Veprimtaria buxhetore dhe financiare e ASHK-së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat. Të ardhurat, që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës. Si garanci për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga veprimtaria kadastrale, ASHK-ja krijon fondin rezervë vjetor, në masën që përcaktohet nga këshilli drejtues.

- Bazuar në Urdhrin Nr.1355 datë.12.05.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, Projekti i Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar ka nisur zyrtarisht punën për kryerjen e regjistrimit fillestar në zonat kadastrale bregdetare , Nr.2863 Palasë, Nr.1739 Gjilekë, Nr.1481 Dhërmi, Nr.1982, Ilias, Nr.3844 Vuno, Nr.1952 Himarë, Nr.2518 Lukovë, Nr.2806 Nivicë. Procesi ka vijuar normalisht , përveç zonës së fshatit Nivicë ku ka pengesa nga ana e banorëve për kryerjen e procesit të verifikimeve /matjeve në terren. Problematika konsiston në: Mungesa e titujve të pronësisë (e AMTP nga banorët e fshatit); Mungesa e hartës që tregon pozicionin gjeografik të parcelës; Mungesa e informacionit të banorëve mbi tokën e fituar (nuk njohin pozicionin gjeografik); Mungesa e banorëve për shkak të emigracionit (ose COVID); Shfaqja e konsiderueshme e mbivendosjeve, pra parcela që zotërohen me titull pronësie nga 2 ose më shume pronarë; Shtëpitë e vjetra , pasi janë të rrënuara, pa banim, dhe ka vështirësi në mbledhjen e informacionit.

- Për vitin 2019 shpenzimet janë bërë të ndara në ZQRPP dhe DP ALUIZNI-t, kanë funksionuar të ndarë dhe me buxhetin e miratuar me parë.

Nga analizimi i shpenzimeve, veçanërisht atyre që konsiderohen me risk si prokurimet publike, është konstatuar se për periudhën janar-tetor 2020 janë zhvilluar kryesisht blerje të vogla me vlerë 11,312,741.06 lekë.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Struktura drejtuese të Agjencia Shtetërore e Kadastrës si òKëshilli Drejtuesò dhe òDrejtori i Përgjithshëmò, në zbatim nr. 111/2018 òPër Kadastrën dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, kanë për objektiv:

Këshilli Drejtues:

Miraton projekt programin buxhetor afatmesëm dhe projekt programin vjetor të veprimtarisë së vitit të ardhshëm financiar, të cilat ia propozon ministrit përgjegjës për financat, si dhe



kontrollon çdo tre muaj drejtimet e përgjithshme të veprimtarisë financiare të Agjencisë; I propozon ministrit përgjegjës për financat miratimin e tarifave të shërbimit të Agjencisë; Miraton rregulloren për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administrojnë ASHK-ja; Miraton raportin vjetor të veprimtarisë, përfshirë edhe çështjet e auditimit të brendshëm; Paraqet Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë raporte për veprimtarinë kadastrale; Miraton ndarjen e zonave të regjistrimit dhe të zonave kadastrale në territorin e Republikës së Shqipërisë; Miraton nënshkrimin e marrëveshjeve me persona fizikë, juridikë, publikë apo privatë, organizata jofitimprurëse, me qëllim rritjen apo përmirësimin e shërbimit kadastral; Paraqet Kryeministrit për miratim strukturën dhe organikën e Agjencisë; Paraqet Kryeministrit nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë, për miratim në Këshillin Ministrave; Miraton kriteret dhe nivelin e shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë; Miraton masën e fondit rezervë vjetor, që shërben si garanci për mbulimin e dëmshpërblimeve, që rrjedhin sipas përcaktimeve të këtij ligji; Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë; Miraton drejtimet politike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, që lidhen me çështje të përditësimit të informacionit në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave.

Drejtori i Përgjithshëm:

Të drejtojnë aktivitetin e Agjencisë në fushat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të zbatimit të legjislacionit për çështjet e pronësisë, sipas objektivave politike të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës; Të hartojnë projektprogramin buxhetor afatmesëm dhe projektprogramin vjetor të veprimtarisë të vitit të ardhshëm financiar; Të hartojnë programe dhe miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë; Të emërojnë dhe lirojnë personelin e Agjencisë, përfshirë dhe drejtuesit e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor; Propozon këshillit drejtues ndërmarrjen e nismës për rishikimin apo ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim mbulimin e kostove të shërbimit dhe menaxhimin me efikasitet të të ardhurave; Ushtron kontroll mbi veprimtarinë e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor, duke përfshirë edhe auditimin, sipas legjislacionit përkatës; Përgatit dhe paraqet në këshillin drejtues raportin vjetor financiar, raportin vjetor për veprimtarinë e institucionit, si dhe raporte periodike, me kërkesë të këshillit; I paraqet këshillit drejtues strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë; I paraqet këshillit drejtues për miratim kriteret dhe nivelet e shpërblimit të punonjësve; Miraton, rast pas rasti, shpërblimin e punonjësve sipas kriterëve dhe niveleve të përcaktuara nga këshilli drejtues; Përfaqëson ligjërisht Agjencinë në marrëdhënie me të tretët; Harton dhe propozon rregulloret që miratohen nga këshilli drejtues; Harton dhe i paraqet Kryeministrit projekt aktet që propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave me karakter individual dhe normativ; Përgatit dhe i paraqet Kryeministrit projektvendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e hartës së vlerës së tokësë, që përmban çmimet e referencës së tokës në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia e llogaritjes së këtyre çmimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave; Detyra të tjera të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

7. Kriteret e vlerësimit



Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 ëPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), ëUdhëzuesit e INTOSAI-të; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligj nr. 20/2020, datë 05.03.2020 ëPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 ëPër Kadastrën; Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 ëKodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, ëPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, i ndryshuar; Ligj nr. 10186, datë 05.11.2019 ëPër rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizminë, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinë, i ndryshuar.

8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 ëPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

9. Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.

Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 ëDokumentimi i Auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligj nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë .06.2019 *ËMbi auditimin tematik me objekt zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për periudhën 6 mujori të vitit 2021*”, Programit të Auditimit nr. 162/4, datë 14.02.2022, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Në përfundim të Auditimit me shkresën nr. 1155/10 datë 12.07.2021 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 1155/1, datë 11.01.2021, për periudhën nga data 01.05.2019 deri më datën 31.12.2020.

Në zbatim të nenit 15, shkronja òjò, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, Drejtoria Përgjithshme e ASHK Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, me nr. 1155/10, datë 12.07.2021, *lidhur me njoftimin për hartimin e programit të punës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.*

Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK Tiranë, nuk është *kthyer përgjigje me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.*

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 19 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative; si dhe janë rekomanduar masa disiplinore òvërejtje deri në largim nga puna ò në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 19 masa organizative, nga të cilat, nga subjekti janë pranuar 11, ndërsa zbatimin tyre rezulton: janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 8 rekomandime.*
- b. *Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “vërejtje deri në largim nga puna” në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm, nga ku rezulton se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, nuk është marrë asnjë masë, për rrjedhojë konsiderohen të pa zbatuara.*

Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të analizojë arsyet për mos përfundimin në kohë të projektit, si dhe të ri vlerësojë edhe njëherë nevojat dhe numrin e saktë të punonjësve të nevojshëm dhe të marrë masa për planifikimin e saktë të afateve për përfundimin e tij, në mënyrë që të evitohen kostot për paga punonjësish duke zgjatur këtë projekt në kohë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.



2.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për analizimin e numrit të punonjësve të nevojshëm veçmas për secilin nga projektet e regjistrimit që ka në proces dhe sipas nevojës të përcaktojë numrin e saktë të punonjësve për secilin prej projekteve me qëllim finalizimin sa më shpejt të dy projekteve të nisura, duke përcaktuar edhe prioritete mes dy regjistrimeve që ka në proces.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për të plotësuar në kohë vendet vakante në strukturë, si dhe të marrë në studim nevojat që ka për të planifikuar më saktë numrin e punonjësve me kontratë, duke përcaktuar edhe afate kohore në lidhjen e kontratave.

Komente: Në mbështetje të nenit 11, pika 3, të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, kandidatët për t’u punësuar pranë ASHK-së i nënshtrohen procedurës së konkurimit. Për këtë arsye, shpallja, zhvillillimi dhe konkludimi i procedurave të konkurimit kërkon kohë. Si rrjedhojë, institucioni është i detyruar t’i plotësojë këto vakanca me emërim të përkohshme ose me emërim për një afat të caktuar kohor, deri në plotësimin e vendeve vakante sipas dispozitave ligjore.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

4.1. Rekomandimi: Njësia e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në ASHK, të marrë masa që në vijimësi të gjithë listë-pagesat të jenë të nënshkruara nga personat e përcaktuar sipas kërkesave të legjislacionit.

Komente: Lidhur me konstatimin tuaj, për mungesën e nënshkrimit në listë-pagesa, nga personat të cilët kanë detyrim ligjor, në vijimësi janë marrë masa dhe nuk ka patur mangësi të tilla.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm ASHK të marrë masa për argumentimin e saktë dhe të mbështetur në bazën ligjore përkatëse për rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, në mënyrë që të evitohen efektet financiare negative në buxhet si pasojë e humbjes së seancave gjyqësore.

Komente: Nga subjekti i audituar jepen sqarime se shkaqet dhe rrethanat e shkeljeve disiplinore dhe përfundimit të marrëdhënies së punës midis ASHK-së dhe punëdhënësit janë parashikuar në nenet 11, 12, 13, dhe 14 të kontratës individuale të punës. Në çdo rast, për çfardollos shkak të jetë inicuar ecuria për diskutimin e marrëdhënieve të punës, institucioni sigurohet të respektoj procedurën sipas nenit 144 të Kodit të Punës, duke I dhënë mundësi punëmarrësit të shprehet dhe diskutojë mbi shkeljet e konstatuara në ngarkim të tijë. Punëdhënësi, në këtë rast ASHK njofton punëmarrësin për takim mbi diskutimin e marrëdhënieve të punës vetëm kur ekziston një shkak i ligjshëm dhe i provueshëm, qoftë kur vjen si një propozim nga eprori direkt, po ashtu edhe në rastet kur shkeljet janë konstatuar nga njësitë e kontrollit ligjor dhe financiar.

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

6.1. Rekomandimi: Nga ASHK, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve afatgjata jo materiale *otoka troje terrenö*, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale;

Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse për evidentimin me evidenca kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2020.



Komente: Në lidhje me këtë rekomandim, Sektori i Financës të DP ASHK-së përcaktoi dhe saktësoi vlerën e aktivitetit afatgjatë Troje , të objektit në zonën kadastrale 8330 në shumën 85,170,000 (lekë), bazuar në cmimin e përcaktuar sipas VKM nr.89, datë 03.02.20216 “Për përcaktimin e vlerës së hartës së tokës në RSH”. U bë evidentimi në regjistrin e aktiveve dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare të vitit 2021.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

7.1. Rekomandimi: ASHK të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi për saktësimin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit për dy ndërtime të paligjshme në pronën e saj, si dhe kryerjen e veprimeve të sistemimit në kartelën e pasurisë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

8.1. Rekomandimi: Nga ana ASHK, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtim e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.

Komente: Nga subjekti në lidhje me këtë rekomandim, sqarohet se për shërbimet e kryera nga punonjësit e administratës të DP ASHK-s nga Zyra e Financës , është kryer në mbështetje të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “ Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, i ndryshuar. Referuar pikës V të këtij Vendimi çdo trajtim financiar i punonjësve të DP ASHK-së, është kryer në mbështetje të Urdhrit të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm. Në këtë urdhër përcaktohet vendi, kohëzgjatja dhe qëllimi i lëvizjes së punonjësit.

Në asnjë pikë të këtij Vendimit të sipërcituar nuk është e cilësuar që punonjësi që dërgohet me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, duhet të dorëzojë në financë për trajtimin financiar , një raport të hollësishëm për qëllimin e shërbimit. Çdo punonjës raporton për qëllimin e lëvizjes te Drejtori përkatës, i cili ka urdhëruar qëllimin e lëvizjes. Çdo urdhërshpenzim për trajtim financiar të punonjësve, që paraqitet në Zyrën e Financës është e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm, punonjësi Udhëtues dhe Drejtori nga i cili varet ky punonjës sipas strukturës. Çdo punonjës raporton për qëllimin e lëvizjes jashtë qendrës së punës te Drejtori përkatës, i cili ka urdhëruar lëvizjen e punonjësit.

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

9.1. Rekomandimi: Nga ASHK, Sektori i Analizës dhe Mbështetjes të merren masat që fletë udhëtimet e harxhimit të karburantit të plotësohen me të gjitha ekstremitetet e tyre, në fund të çdo muaji të nënshkruhen nga personat udhëtues të cilët kanë përdorur kartën e tërheqjes së karburantit, duke i bashkëlidhur kuponët e nxjerrë nga kasa fiskale.

Komente: Nga ana e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse janë marrë masa për plotësimin e dokumentacionit justifikues për harxhimin e karburantit. Nga cdo shofer plotësohet e fletë-udhëtimi për cdo lëvizje me destinacionin përkatës, të cilat nënshkruhen nga personat udhëtues. Gjithashtu kryhen rakordimet në fund të cdo muaji lidhur me furnizimet sipas kartave dhe kilometrat e përshkuara nga automjeti.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

10.1. Rekomandimi: ASHK Drejtoria e Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa të hartojnë urdhrat për përfituesit dhe mënyrën e përdorimit të telefonave celularë.

Komente: Në lidhje me këtë rekomandim, kompensimi i shpenzimeve për telefonat celularë të punonjësve të DP ASHK-së, bëhet në bazë të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.45, datë



25.05.2021 “Për kompensimin e shërbimit të telefonisë celulare të punonjësve të DP ASHK-së”.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa, që të eliminojnë kryerjen dhe pagesën e shërbimeve në ditët e shtuna në respektim dhe të kontratave individuale të punës me punonjësit. Në rastet specifike, të paraqesin dhe të miratojnë në Bordin Drejtues afatet e kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe fondet përkatëse.

Komente: Në lidhje me këtë rekomandim, Sektori i Financës ka eliminuar kryerjen e pagesave të shërbimeve të punonjësve jashtë qendrës së punës në ditët e shtuna.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

12.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, të propozojë për miratim në Bordin Drejtues investimin e fondeve të disponueshme dhe në gjendje të lirë në llogaritë bankare, në depozita apo bono thesari në Bankën e Shqipërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore dhe krijimin e të ardhurave për institucionin për përballimin e kostove të marrjes me qira të ambienteve dhe për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Komente: Në lidhje me këtë rekomandim, mjetet e lira në llogaritë rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë të DP ASHK-së. Në fund të vitit 2020 gjendja e llogarive rrjedhëse në DP ASHK-së është 1,455,667,619 lekë e cila përfshin të ardhurën e papërdorur dhe që është trashëguar vit mbas viti në mbështetje të Ligjit nr.33/2012 “ Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme “, i ndryshuar, i shfuqizuar me ligjin nr.111/2018 “ Për Kadastrën”. Në ligjin nr.111/2018 “ Për Kadastrën”, Kreu II, neni 6 “Statuti dhe financimi i ASHK-së”, nuk parashikohet që fondet e lira të institucionit të investohen në depozita apo bono thesari, në mënyrë që të krijojnë të ardhura të tjera për ASHK.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

13.1.Rekomandim: Titullari i ASHK të përcaktojë personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave (monitorimet), si dhe të përgatiten raportet përmbledhëse për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit.

-Drejtoria e Financës në ASHK të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin që nënshkruhen kontratat midis operatorit ekonomik dhe Institucionit, apo kur lind një detyrim.

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

14.1.Rekomandimi: ASHK të marrë masa për parashikimin në buxhetet vjetore të shpenzimeve për marrjen e ambienteve me qira, duke marrë dhe miratimin rast pas rasti të Këshillit Drejtues. Meqenëse ASHK disponon fonde të lira të konsiderueshme të shohë me përparësi mundësinë e rikonstruksionit të godinës, të dëmtuar nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim uljen e shpenzimeve të qirave marrjes.

Komente: përsa i takon kontratës së qirasë, lidhur me personin fizik P.K, për një periudhë 5 vjeçare, se duhej bërë me procedurë prokurimi pasi tejkalon kufijtë e vlerës për tenderin e hapur, sqarojmë se: Duke qënë se sipas ligjit të prokurimit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), në nenin 7, citohet si më poshtë vijon:

Ky ligj nuk zbatohet në kontratat e shërbimit publik për: **a) blerjen ose qiranë**, me çdo mjet financiar të pasurive të paluajtshme apo të të drejtave mbi to. Bëjnë përjashtim kontratat për shërbime financiare, të lidhura në atë çast, para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë së çdo forme, të cilat i nënshtrohen këtij ligji, në këto kushte nuk mund të kryhet procedurë



prokurimi, pasi janë të përjashtuara, pavarësisht vlerës.

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

15.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të merren masa që; në hartimin e planeve vjetorë të auditimit të parashikohen auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme; në raportet e veprimtarisë vjetore të arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan.

Komente: *Menjëherë pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të KLSH-së dhe rekomandimit të lënë në të, u krye gjatë vitit 2021 nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë angazhimeve të kryera, në 6 Drejtori Vendore dhe nga 74 rekomandime të lëna gjithsej rezultoi se:*

- ❖ 55 rekomandime, ose 74% e rekomandimeve të dhëna kanë gjetur zbatim.*
- ❖ 5 rekomandime ose 7% e rekomandimeve të dhëna, janë në proces zbatimi por të papërfunduara plotësisht.*
- ❖ 12 rekomandime, ose 16.2 % e rekomandimeve të dhëna, nuk janë zbatuar.*
- ❖ 2 rekomandime, ose 2.8% e rekomandimeve të dhëna, nuk janë pranuar. Një rekomandim nuk është pranuar gjatë procesit të auditimit nga specialistët përgjegjës dhe një rekomandim tjetër nuk është pranuar nga menaxhimi i emëruar rishtas.*

Me shkresën nr.491/1 datë 08.02.2022 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Raporti Vjetor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, pjesë e të cilit janë si ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm edhe arsyetimi i mosrealizimit të planit vjetor të auditimit për vitin 2021.

Gjithashtu mbështetur në Ligjin e Auditimit të Brendshëm 114/2015 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.42 datë 27.10.2020 "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm në Sektorin Publik" në Programin Vjetor të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm, është përfshirë auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme në Drejtoritë Vendore të ASHK-së Elbasan, Lezhë si dhe në Zyrat Vendore të ASHK-së: Librazhd, Peqin, Gramsh, Kurbin dhe Mirditë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

16.1.Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa që të nxisë shqyrtimin sa më parë të akteve nënligjore të dërguara tashmë dhe atyre që do të dërgohen në vijim në zbatim të Ligjit 111/2018, në mënyrë që të shmangen pasaktësitë dhe keq interpretimet e ligjit në fjalë si pasojë e mungesës së akteve nënligjore plotësuese.

Komente: *Përsa i përket konstatimeve mbi veprimtarinë e Sektorit Juridik dhe Hartimit të Legjislacionit mbi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe Ligjin nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" , shpjegojmë sa më poshtë:*

- Në lidhje me projektaktet e ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" nga verifikimi i bërë pasqyrës së projektakteve, KLSH parashtron faktin se duhet të nxireshin 18 projektakte brenda periudhës Mars 2020. Nga këto janë miratuar 13 akte nënligjore, ndërkohë 5 akte janë hartuar/draftuar jashtë afatit dhe ende nuk janë miratuar.

Në lidhje me konstatimin për 5 aktet e pa miratuara, parashtrojmë se, projektaktet "Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme" dhe "Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e të drejtës nga personat juridik/fizike vendas apo të huaj për të patur akses në sistemin elektronik dhe lista



se institucioneve ...” janë përcjellë për miratim në Këshill të Ministrave me shkresën nr.17805, datë 11.12.2020 dhe këto akte janë miratuar me VKM nr. 1179, datë 24.12.2020 “Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave”.

Ndërkohë projektaktet si më poshtë:

- “Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK”;

- “Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”;

- “Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi”;

janë draftuar/formalizuar nga ASHK si projektakte, ndodhen në fazë konsultimi dhe do përcillen me përparësi për shqyrtim në KM sipas planit të përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2022, miratuar me VKM nr.850, datë 29.12.2021 “Për miratimin e programit analitik të përgjithshëm të projektakteve që do ti paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022”.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa që të nxisë shqyrtimin sa më parë të akteve nënligjore të dërguara tashmë dhe atyre që do të dërgohen në vijim në zbatim të Ligjit 20/2020, në mënyrë që të shmangen pasaktësitë dhe keq interpretimet e ligjit në fjalë si pasojë e mungesës së akteve nënligjore plotësuese.

Komente: Në lidhje me projektaktet e ligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, nga verifikimi i bërë pasqyrës së projektakteve, KLSH parashtron faktin se duhet të nxireshin 19 projektakte brenda periudhës Prill 2021. Nga këto janë miratuar 3 akte nënligjore, ndërkohë 9 akte janë përcjellë për miratim në KM dhe 7 janë hartuar/draftuar dhe do të përcillen për miratim në KM.

Ndërkohë, 1 nga projektaktet e tjera është përcjellë për miratim në Këshillin e Ministrave dhe 6 projektakte të tjera janë draftuar/formalizuar nga ASHK dhe janë në proces konsultimi dhe përcjellje nga ASHK në Këshill të Ministrave për miratim, në përputhje me planin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2022 të ASHK.

Drejtoria e Përgjithshme e ka patur dhe e ka prioritet procesin e hartimit të këtyre akteve dhe duke e patur në vëmendje të shtuar po punon intensivisht për përmbylljen e këtij procesi me intensitet.

Ndërkohë, zbatimi i rekomandimeve mbi përfundimin e procesit të mbylljes së procedurave për aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018 dhe nr.20/2020, është prioritet për ne dhe po punohet intensivisht për përmbylljen e këtij procesi, në bashkëpunim dhe konsultim edhe me institucione të tjera që preken nga miratimi i këtyre akteve.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

18.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për shkeljet e konstatuara nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit, të ketë në konsideratë aplikimin e sanksioneve në përputhje me referencat ligjore të mos zbatuara duke mos aplikuar masa disiplinore së bashku me kundërvajtjet administrative kur dispozita e referuar pika 2, neni 64 të ligjit 111/2018 òPër Kadastrënò parashikon vetëm vendosjen e dënimit me gjobë.

Komente: Për sa më sipër nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit po zbatohet neni 64, i ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. Në përfundim ju informojmë se Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit, ka zbatuar në vijim, rekomandimin e sipërcituar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.



Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

19.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si eprorë të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit të nxjerrë përgjegjësitë për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave të ardhura, për vonesat në përgjigje përtej afateve ligjore të përcaktuara si dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të Drejtorive Vendore e personave përgjegjës.

Komente: Në lidhje me pretendimin se ankesat me përgjigje nuk janë trajtuar brenda afateve ligjore me arsyetimin për shkak të situatës të krijuar nga pandemia, ***sqarojmë se është fakt i njohur botërisht dhe nuk është justifikim, Gjithashtu, mbështetur kjo dhe në neni 91 të Kodit të Procedurës Administrative, në të cilin citohet se: Afati për përfundimin e procedurës administrative në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Situatë e cila përfundoi më datë 01.06.2020, kur Shqipëria filloi zbatimin e Protokolleve të zonës së Verdhë të parashikuara nga OBSH.***

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

A. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa òdò dhe òeò dhe nenit 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 òPër Kadastrën, të ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës, ***Drejtori i Përgjithshëm***, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe për personat përgjegjës të aplikojë marrjen e masave disiplinore nga “***Vërejtje***” deri në “***Vërejtje me paralajmërim***”.

Rekomandimi konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2016 ish ZQRPP ka iniciuar një projekt me objekt òPërmirësimi/përditësimi, regjistrimi fillestar dhe dixhitalizimi i të dhënave të pasurive të paluajtshme. Referuar Vendimit të Bordit Drejtues të ish ZQRPP nr. 6, datë 06.07.2016, ky projekt synon të ofrojë akses për një informacion të përmirësuar/përditësuar mbi të drejtat e pasurive të paluajtshme në 181 ZK, si dhe regjistrimin fillestar në 22 ZK. Sipas analizës financiare të miratuar nga Bordi Drejtues rezulton se projekti do të shtrihet në një afat kohor prej 3 vitesh (2016-2018) dhe do të ketë një kosto totale prej 2,216,211,121 lekë. Për realizimin e këtij projekti, me vendimin e sipër përmendur Bordi Drejtues ka miratuar edhe nënshkrimin e kontratave të përkohshme për punësimin e 382 punonjësve për këtë qëllim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se edhe pas përfundimit të afatit të projektit, pra pas vitit 2018, ky projekt nuk ka përfunduar dhe me Vendimin nr. 8, datë 20/12/2018 dhe Vendimin nr. 22, datë 21/12/2020, Bordi Drejtues ka vijuar të miratojë numrin prej 382 punonjësish me kontratë të përkohshme për vijimin e projektit. Mos përfundimi i projektit brenda afateve të miratuara, (brenda vitit 2018) dhe shtrirja e tij në kohë edhe për 3 vite të tjera (deri në vitin 2021 momenti i auditimit), ka bërë që buxheti i



ASHK të ngarkohet me kosto të shtuara për vitet 2019-2021. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 30-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të analizojë arsyet për mos përfundimin në kohë të projektit, si dhe të ri vlerësojë edhe njëherë nevojat dhe numrin e saktë të punonjësve të nevojshëm dhe të marrë masa për planifikimin e saktë të afateve për përfundimin e tij, në mënyrë që të evitohen kostot për paga punonjësish duke zgjatur këtë projekt në kohë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi Nga auditimi konstatohet: Me VKM nr. 708, datë 21/11/2018 është miratuar regjistrimi dhe kalimi në përgjegjësi administrimi të Ministrisë përgjegjëse për Turizmin i disa pronave të paluajtshme shtetërore në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë. Për këtë qëllim, me Vendim të Bordit Drejtues të ASHK nr. 5, datë 16/05/2019 është miratuar regjistrimi fillestar për zonat kadastrale të përcaktuara në VKM e sipër përmendur. Në vijim, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK nr. 1355, datë 12/05/2020 ka filluar procesi i regjistrimit fillestar për 8 zonat kadastrale të vijës bregdetare Vlorë-Sarandë. Referuar pikës 3 të këtij urdhri, ky proces do të kryhet nga Projekti ÷Përmirësim/përditësim dhe regjistrim fillestar. Në zbatim të këtij urdhri, punonjësit me kontratë janë angazhuar njëkohësisht për të dy proceset e regjistrimit, pa përfunduar më parë plotësisht projektin e iniciuar që në vitin 2016. Krahas këtij konstatimi, vihet re se në asnjë rast ASHK nuk ka punësuar numrin e plotë të punonjësve të nevojshëm sipas miratimit prej 382 punonjës, por ka punuar mesatarisht me rreth 60% të punonjësve të nevojshëm. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 30-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për analizimin e numrit të punonjësve të nevojshëm veçmas për secilin nga projektet e regjistrimit që ka në proces dhe sipas nevojës të përcaktojë numrin e saktë të punonjësve për secilin prej projekteve me qëllim finalizimin sa më shpejt të dy projekteve të nisura, duke përcaktuar edhe prioritete mes dy regjistrimeve që ka në proces.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK në periudhën objekt auditimi janë likuiduar detyrimet në vlerën totale prej 2,938,704 lekë, për 3 raste Vendimesh Gjyqësore të konkluduara në dëm të ASHK për largimet nga puna të punonjësve *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm ASHK të marrë masa për argumentimin e saktë dhe të mbështetur në bazën ligjore përkatëse për rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, në mënyrë që të evitohen efektet financiare negative në buxhet si pasojë e humbjes së seancave gjyqësore.

Menjëherë.

4. Gjetje nga auditimi: Në Pasqyrat Financiare të vitit 2019 ÷Llogaria 212” paraqitet në shumën 133,289,805 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet e kryera në vitin 2005 nga financuesi i rikonstruksionit të ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë (Projekti i Shërbimeve Bujqësore óASP Tiranë) në vlerën 97,172,310 lekë, si dhe vlera e rikonstruksioneve në vitet 2006-2018, të reflektuara këto në regjistrin e aktiveve të institucionit, për ish godinën e ZRPP me 6 kate, që sipas VKM nr. 411, datë 27.10.2014 tre kate me sipërfaqe 2500 m² i kanë kaluar në administrim të ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Tiranë, e cila aktualisht në vitin 2020 është në pronësi të ASHK.

Në Kartelën e Pasurisë lëshuar më datë 13.03.2019, në Seksionin E, nga Regjistruesi është bërë shënimi ÷ndërtime të paligjshme, ndërsa në Hartën Treguese të Regjistrimit me indeks TR-L-9 lëshuar po më datë 13.03.2019 në Pasurinë NR 8/114 ndodhen dhe dy ndërtesa të



tjera, por nga ASHK nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sistemimin e pronës. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: ASHK të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi për saktësimin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit për dy ndërtimet e paligjshme në pronën e saj, si dhe kryerjen e veprimeve të sistemimit në kartelën e pasurisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpenzimet e kryera për udhëtim e dieta rezultoi se, urdhër shpenzimet e punonjësve janë autorizuar me shkrim nga titullari i institucionit, por në disa raste faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga punonjësi udhëtues dhe nuk ishin të shoqëruara me relacion apo raportime për objektivat e shërbimit, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, KREU 3, pika 36. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Nga ana ASHK, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtim e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të lidhura ndërmjet AKSHI-it dhe Operatorëve Ekonomikë, për sistemet IT, zbatimi i të cilave monitorohet dhe likuidohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës konstatohet se, në këto kontrata nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.

-Gjithashtu, nuk janë dokumentuar kontrollet (monitorimet), gjatë zbatimit dhe në përfundim të kontratave, Autoriteti Kontraktor (të ngarkuarit me ndjekjen e kontratës), nuk kanë përgatitur raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 77 (Mbikëqyrja e Kontratës) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku përcaktohet: për të siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet, e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62, të LPP-së. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

-Nga ASHK është likuiduar subjekti ëBë SHPK më datë 27.12.2019, në shumën 6,029,376 lekë, sipas faturës tatimore datë 11.04.2019 dhe akt-marrjes në dorëzim datë 11.04.2019, me objekt blerje servera databaze dhe stronga, për përmirësimin e Arkivës Dixhitale, pra me 8 muaj vonësë nga marrja e shërbimit. Konstatohet se, nga Dega Financës nuk janë kryer kontabilizimet në momentin e lidhjes së kontratave shërbimeve të mirëmbajtjes së rrjeteve informatike, apo të lindjes së detyrimit dhe për vlerën e plotë të kontratave, por kontabilizimi është kryer në momentin e mbërritjes së faturave dhe kryerjes së pagesave, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 61-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Titullari i ASHK të përcaktojë personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave (monitorimet), si dhe të përgatiten raportet përmbledhëse për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit.



-Drejtoria e Financës në ASHK të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin që nënshkruhen kontratat midis operatorit ekonomik dhe Institucionit, apo kur lind një detyrim.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për marrje ambientesh me qira, konstatohet se, institucioni për vitet 2019-2020 ka lidhur *gjithsej 4 kontrata, në shumën 13,440,636 lekë*. Ambientet janë marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit të disa prej drejtorive të ASHK, pas bashkimit të dy institucioneve (ZRPP dhe ALUIZNI), *të pa parashikuar dhe miratuar në buxhetet vjetore dhe pa kryer procedura tenderimi, si dhe pa miratimin nga Këshilli Drejtues për kryerjen e këtij shërbimi, ndërsa në një rast lidhja e kontratës për marrjen e ambienteve me qira nga titullari është për 5 vite, pra në të gjitha rastet janë tejkualuar kompetencat e titullarit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 111/2018 òPër Kadastrën, i ndryshuar dhe me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, duke sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerë 13,441 mijë lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 61-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: ASHK të marrë masa për parashikimin në buxhetet vjetore të shpenzimeve për marrjen e ambienteve me qira, duke marrë dhe miratimin rast pas rasti të Këshillit Drejtues. Meqenëse ASHK disponon fonde të lira të konsiderueshme të shohë me përparësi mundësinë e rikonstruksionit të godinës, të dëmtuar nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim uljen e shpenzimeve të qirave marrjes.

Menjëherë.

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Maj 2019 - 31/12/2020, Sektori i Marrëdhënive me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit ka trajtuar 1111 praktika nga 1921 praktika të ardhura gjithsej ose 57.8 % të praktikave të administruara. Referuar të dhënave të administruara nga ky sektor, vihet re se niveli i trajtimit të kërkesave/ankesave nuk është ai i duhur ku për një periudhë 1.5 vjeçare u jepet zgjidhje mesatarisht 52% të tyre. Nga ku u konstatua se:

-nuk ka një dokumentacion për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave apo një delegim të tyre sipas kompetencave ligjore, personave përgjegjës

-në ankesat me përgjigje në asnjë rast nuk është zbatuar afati i përgjigjes në përputhje e zbatim të òKodit të Procedurave Administrative si dhe nuk ka dokumentacion për të justifikuar zgjatjen kohore të përgjigjeve mbi arsyetimin se; çështjeve që duhet të kryhet hetim administrativ u nevojitet kohe me e madhe për përgjigje si dhe për shkak të situatës të krijuar nga pandemia,

-për çështjet e ankimuar me problematika që duhet të zgjidhen nga Drejtorive Vendore sipas detyrimeve ligjore në asnjë rast nuk ka një analizë apo nxjerrje përgjegjësie për Drejtoritë Vendore apo dhe për persona përgjegjës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 109-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si eprorë të Sektorit të Marrëdhënive me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit të nxjerrë përgjegjësitë për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave të ardhura, për vonesat në përgjigje përtej afateve ligjore të përcaktuara si dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të Drejtorive Vendore e personave përgjegjës.

Menjëherë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT RAPORT AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË ASHK

Rekomandim: Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa òdò dhe òeò dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 òPër Kadastrën, të ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës, **Drejtori i Përgjithshëm**, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe për personat përgjegjës të aplikojë marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT